



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I KOMUNITETIT DHE MBËSHTETËS

Nr. ____ Prot.

Maliq më 07.09.2017

Procesverbal

I mbajtur në takimin e buxhetimit ku marin pjesë banorët e Njësive Administrative Lozhan

Në kuadër të ligjit **nr. 146/2014, neni 18** “*Pjesëmarrja në takime Publike*”, u mbajt sot, më **dt.07.09.2017 ora 10:00** në sallën e mbledhjeve të Njesisë Administrative Lozhan takimi konsultativ (dëgjesa publike) mbi programin buxhetor afatmesem 2018-2020, si dhe për buxhetin vjetor, pjesë e buxhetit afatmesëm.

Në takim morën pjesë : Kryetari i Bashkisë Maliq: z.Gëzim Topçiu , drejtues dhe specialist të Bashkisë Maliq, banorë të Njesisë Administrative Lozhan, Kryetarë të Fshatrave, përfaqësues të bizneseve, shoqatave, si dhe grupe të tjera të interesit.

Në vijim të procesit të hartimit dhe përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm për periudhën 2018-2020, dhe për buxhetin vjetor 2018, takuam dhe dëgjua banorët e Njesisë Administrative Lozhan ,për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve që do të realizohen nga Bashkia Maliq ,me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat ku këta banorë jetojnë .Gjatë diskutimit ,në thelb të dëgjësave publike ishin jo vetëm punët dhe investimet e kryera nga Bashkia Maliq gjatë këtyre dy viteve, por dhe kërkesave e nevojave thelbësore në lidhje me përmirësimin e një sërë shërbimesh si ç’janë:

Furnizimi me ujë të pijshëm dhe ndriçimi publik,sistemimi i kanaleve ujitës dhe kullues në parcelat bujqësore, sistemimi i rrugëve hyrëse në fshatra dhe rrugëve dytësore për në parcelat bujqësore.Theksi u v’u dhe tek përmirësimi i disa objekteve, si kopshte, shkolla, furnizimi me dru zjarri etj.

Takimi u hap me fjalën e Kryetarit të Bashkisë Maliq, e cila u pasua me prezantimin e Projekt-Buxhetit për periudhën **2018-2020**, u bë një analizë e investimeve dhe punëve që janë kryer nga Bashkia Maliq gjatë kësaj periudhe, si dhe u propozua hedhja e ideve dhe mendimeve të banorëve të komunitetit për të përcaktuar prioritetet e investimeve dhe alokimin e fondeve sipas nevojave dhe kërkesave të komunitetit.

Pas prezantimit u vijua me komente dhe pyetje të pjesëmarrësve, të cilëve i’u përgjigjën drejtues dhe specialistë të Bashkisë që mbulojnë sektorët përkatës.

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Stiljan Belishta